



Qeveria shqiptare garanton ndihmë financiare ekstra dhe resurset e nevojshme për të përballuar krizat natyrore



» faqe 3



KRONIKË: KUR UNIFORMA LAGET ME DJERSË E HI - SAKRIFICA QË NUK MATET ME ORË

Në ditët kur flakët përpinë hektarë të tërë pyjesh e kullotash, kur ajri u mbush me tym e hi, forcat e armatosura u gjendën në vijën e parë të frontit. Ata nuk mbanin pushkë, por lopata, pompa uji, dhe mbi të gjitha një vendosmëri të palëkundur për të mbrojtur jetën e njerëzve dhe pasurinë e vendit. Për orë të tëra, shpesh pa pushim, efektivet e ushtrisë përballuan temperatura të larta, terrere të vështira dhe rrezikun e përhershëm të rrethimit nga zjarri. Ata ecën në këmbë për kilometra...



» faqe 2



NË MAJAT E KARRIERËS USHTARAKE - GJENERALLEJTËNANT KINGJI DHE BESIMI PËR TRE VITET E ARDHSME

Gushti i vitit 2025 solli një tjetër moment kulmor në rrugëtimin e tij. Më 11 gusht 2025, në një ceremoni zyrtare në mjediset e Presidencës, Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, e dekretoi gjenerallejtënant Arben Kingjin në detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për një mandat të dytë trevjeçar. Ceremonia nisi me ekzekutimin solemn të Himnit Kombëtar, ndërsa tingujt e tij...



» faqe 4



FORCAT SHQIPTARE NË STËRVITJEN VERBOOM TË NATO-s NË LETONI, SHKËMBIM EKSPERIENCASH DHE FORCIM I SIGURISË KOLEKTIVE

Stërvitja intensive me aleatët në Letoni përgatit Forcat Tona për sfidat e ardhshme në Europë. Pjesëmarrja e Forcave Shqiptare në ushtrimin VERBOOM të NATO-s në Letoni ka një ndikim të drejtpërdrejtë dhe multidimensional në gatishmërinë e tyre për operacione të ardhshme jashtë vendit si përforcimi i aftësive taktike dhe teknike. Trajnimet në terren të vështirë (si klimën e ftohtë dhe terrenin malor të Letonisë) përmirësojnë...



» faqe 2

Kronikë: Kur uniforma laget me djersë e hi – sakrifica që nuk matet me orë

Në ditët kur flakët përpinë hektarë të tërë pyjesh e kullotash, kur ajri u mbush me tym e hi, forcat e armatosura u gjendën në vijën e parë të frontit. Ata nuk mbanin pushkë, por lopata, pompa uji, dhe mbi të gjitha një vendosmëri të palëkundur për të mbrojtur jetën e njerëzve dhe pasurinë e vendit.

Për orë të tëra, shpesh pa pushim, efektivët e ushtrisë përballuan temperatura të larta, terrene të vështira dhe rrezikun e përhershëm të rrethimit nga zjarri. Ata ecën në këmbë për kilometra, bartën pajisje të rënda dhe luftuan me flakët edhe aty ku mjetet e tjera nuk arrinin.

Një nga pamjet më të prekshme ishte ajo e dhjetëra ushtarëve të shtrirë përtokë, në hije, të kapur nga gjumi aty ku lodhja i kishte rrëzuar. Pa çadra, pa komoditet, vetëm uniforma e pluhurosur dhe fytyra të mbuluara me djersë e hi. Ishte pushimi i shkurtër mes dy betejave të gjata – një moment i qetësisë mes një lufte pa armë zjarri, por me një armik po aq të pamëshirshëm: zjarrin.

Ky përkushtim nuk është vetëm detyrë, por një shërbim i pastër ndaj atdheut. Në këto ditë të nxehta, ushtria tregoi se gatishmëria e saj nuk kufizohet vetëm në mbrojtjen nga kërcënimet ushtarake, por shtrihet edhe në përballimin e fatkeqësive natyrore.

Në heshtje, pa shumë fjalë e bujë, këta burra dhe gra në uniformë dhanë gjithçka që kishin – forcat e tyre, kohën, madje dhe gjumin – për të siguruar që zjarret të shuheshin dhe njerëzit të ishin të sigurt. Ky është portreti i vërtetë i sakrificës: jo vetëm në fushëbetje, por edhe në malet dhe pyjet e përfshira nga flakët.



Forcat Shqiptare në stërvitjen VERBOOM të NATO-s në Letoni, shkëmbim eksperiencash dhe Forcim i Sigurisë Kolektive

Stërvitja intensive me aleatët në Letoni përgatit Forcat Tona për sfidat e ardhshme në Europë. Pjesëmarrja e Forcave Shqiptare në ushtrimin VERBOOM të NATO-s në Letoni ka një ndikim të drejtpërdrejtë dhe multidimensional në gatishmërinë e tyre për operacione të ardhshme jashtë vendit si përforcimi i aftësive taktike dhe teknike. Trajnimet në terren të vështirë (si klimën e ftohtë dhe terrenin malor të Letonisë) përmirësojnë adaptueshmërinë e xhenios në ambiente të ndryshme operative. Përdorimi i pajisjeve të reja të NATO-s dhe simulimet e skenarëve realë (si mbrojtja e infrastrukturës kritike) rritin kompetencat teknike. Koordinimi me trupat aleate përforcon standarde të unifikuara të komunikimit, logjistikës dhe vendimmarrjes, duke bërë operacionet e ardhshme më të shpejta dhe efikase. Mësimet nga taktikat e aleatëve (p.sh., strategjitë antiterroriste të Francës ose operacionet kërkimore-shpëtuese të Kanadasë) zgjerojnë “arsenalin” operativ të Shqipërisë. Ushtrimet kundër kërcënimeve hibride (si cyber-sulmet ose dezinformimi) përgatisin xhenion për sfidat moderne të luftërave jo-tradicionale. Simulimet e evakuimit civil dhe mbrojtjes së popullatës civile ndërtojnë eksperiencë për misione humanitare. Puna në ekipe multinacionale rrit vetëbesimin e ushtarëve në aftësinë e tyre për të integruar forcat në një strukturë globale. Testimi i qëndrueshmërisë fizike dhe mendore në kushte ekstreme forcon qëndrueshmërinë kolektive.



Përgatitje për Misione të Mëdha në NATO

Pjesëmarrja në VERBOOM vërteton se Shqipëria mund të jetë një partner aktiv në operacione si Mbrojtja e anës lindore të NATO-s (në Letoni, Lituanë, etj.) si dhe misionet e menaxhimit të krizave në Afrikë ose Lindjen e Mesme.

Ushtrimi VERBOOM nuk është thjesht një “provë fizike”, është një provë për NATO-n që Shqipëria është gati të marrë përgjegjësi më të larta në skenën ndërkombëtare. Kjo përvojë krijon një kulturë të re operative, ku xheniot tanë nuk janë vetëm pjesëmarrës, por edhe kontribuues aktivë në sigurinë globale.

Anija “Lissus” P-133, në operacionin e NATO-s në Detin Egje: Kontribut i çmuar i forcave shqiptare për paqe dhe siguri ndërkombëtare

Nën komandën e Shtabit të Përgjithshëm, “Lissus” do të operojë me një ekip shumë profesional, të trajnuar sipas standardeve më të larta të Aleancës. Ministria e Mbrojtjes theksoi: “Ky operacion nuk është vetëm një detyrë ushtarake, por edhe një dëshmi e pandryshueshme e besnikërisë sonë ndaj vlerave të NATO-s. Jemi krenarë që kontribuojmë në sigurinë kolektive dhe në mbrojtjen e jetëve njerëzore”. Qëllimi kryesor i këtij misioni është monitorimi i trafikut detar, lufta kundër aktiviteteve të paligjshme dhe mbështetja e operacioneve humanitare, bashkëpunimi me aleatët dhe koordinim i ngushtë me anijet e shteteve anëtare të NATO-s për shkëmbim informacioni dhe strategjish. Stafi i “Lissus” ka përfunduar stërvitjen intensive për situata krizash, duke përfshirë shpëtimin e emigranteve dhe operacione kërkimore.

Angazhimi i Shqipërisë në NATO vazhdon të forcohet, duke reflektuar një vizion të qartë për stabilizimin e Ballkanit dhe Evropës. Operacioni i Detit Egje do të jetë një shtyllë tjetër në historinë e sukseseve të Forcave të Armatosura Shqiptare.

Ky mision simbolizon përpjekjet e vazhdueshme të Shqipërisë për të qenë një aleat i besueshëm dhe aktiv, duke respektuar parimet e NATO-s për unitet, paqe dhe mbrojtje të demokracisë.



Qeveria shqiptare garanton ndihmë financiare ekstra dhe resurset e nevojshme për të përballuar krizat natyrore

Kryeministri Edi Rama ka shprehur mirënjohjen e thellë dhe respektin e plotë ndaj zjarrfikësve, Forcave të Armatosura dhe strukturave vendore që luftuan pa pushim për të shuar zjarret në të gjithë vendin. Në një deklaratë publike, Rama theksoi se angazhimi i tyre ka qenë "shembull i rezistencës dhe sakrificës për mbrojtjen e shoqërisë".

"Siç kemi bërë edhe në vitet e shkuara, përtej të gjithë nderimeve dhe shprehjes së admirimit me fjalë, do kryejmë edhe mbështetjen ekstra financiare për zjarrfikësit dhe Forcat e Armatosura si ata që ishin në krye të kësaj beteje kundër zjarreve të çmendura. Kemi koordinuar 368 mjete zjarrfikëse nga të gjitha strukturat vendore, si dhe 635 mjete të tjera me kapacitete të ndryshme, duke siguruar një përgjigje të shpejtë dhe efektive", - u shpreh kryeministri i vendit z. Edi Rama.

Forcat e armatosura, zjarrfikësit, policia dhe autoritetet lokale punuan në një rrjet të unifikuar operativ, duke optimizuar përdorimin e burimeve. Mjetet përfshinin jo vetëm automjete speciale zjarrfikëse, por edhe pajisje për shpërndarjen e ujit, traktorë për hapjen e korridoreve mbrojtëse, dhe sisteme komunikimi të avancuara.

Kryeministri Rama premtoi që do të rritet buxheti për blerjen e pajisjeve moderne dhe trajnimet.

Zjarret e këtij viti, të ndezur nga



temperaturat rekord dhe thatësiat ekstreme, kanë testuar kapacitetin e Shqipërisë për të përballuar krizat natyrore. Sipas raporteve, më shumë se 10,000 hektarë pyje dhe tokash bujqësore u shkatërruan, por ndërhyrja

e shpejtë ndaloi humbje njerëzore. Forcat e Armatosura po përgatiten për të integruar teknologji e dronë dhe sisteme parashikimi të inteligjencës artificiale në monitorimin e zonave të rrezikuara. "Kjo nuk është vetëm një beteje kundër zjarreve, është

një beteje për të ruajtur besimin e qytetarëve në shtetin e tyre", - theksoi kryeministri Rama. Me mbështetjen e qëndrueshme financiare dhe modernizimin e kapaciteteve, Shqipëria synon të jetë gati për sfidat e ardhshme klimatike.

Zjarr në çdo cep të vendit - Ushtria dhe strukturat e emergjencave në beteje të pandërprerë

Gjatë 24 orëve të fundit, janë evidentuar 37 vatra zjarri aktive në të gjithë vendin, me përhapje të rrezikshme në disa qarqe.

Situata më problematike mbetet në Vlorë, Elbasan, Gjirokastrë, Shkodër, Tiranë, Dibër dhe Korçë, ku forcat e armatosura, zjarrfikësit, policia, strukturat bashkiake dhe qindra vullnetarë kanë qenë në terren ditë e natë.

Në Vlorë (Delvinë e Finiq) flakët kanë depërtuar në lagje të banuara dhe kanë djegur disa shtëpi. Operacionet janë mbështetur nga ajri me helikopterë çek dhe slovak. Në Elbasan (Gramsh), zjarri ka marrë përmasa të mëdha, duke shkaktuar dëme të konsiderueshme dhe një viktimë, ndërsa është dhënë urdher evakuimi për disa fshatra.

Në Tepelenë (Gjirokastrë) janë djegur stalla dhe bagëti, ndërsa në Shkodër (Fushë Arrëz) dhe Tiranë (Bërzhitë, Arbanë) situata është mbajtur nën kontroll me ndërhyrje të kombinuara tokësore e ajrore. Në Dibër dhe Korçë, zjarret po përhapen në zona të mbrojtura e me terren të vështirë,



përfshirë edhe rrezikun nga municionet e vjetra në Gërmenj.

Forca të shumta të FA janë dislokuar në çdo vatër të rrezikshme, duke punuar krah për krah me shërbimet zjarrfikëse, policinë,

emergjencat civile dhe banorët.

Parashikimet meteorologjike për temperatura të larta dhe erëra të forta rrisin rrezikun e riaktivizimit të flakëve, ndaj autoritetet bëjnë thirrje për vigjilencë dhe

raportim të menjëhershëm të çdo vatre të re. Kjo është një provë e madhe për vendin, ku ushtria dhe qytetarët po luftojnë krah për krah për të mbrojtur jetën, pronën dhe mjedisin.





NGA MAJOR (R) NEXHBEDIN BASHA

Në majat e karrierës ushtarake – Gjenerallejtënant Kingji dhe besimi për tre vitet e ardhshme

Pas gradës ‘gjenerallejtënant’, Arben Kingji merr përsëri besimin e lartë, duke drejtuar Forcat e Armatosura, në një mandat trevjeçar plot sfida dhe shpresë.

Në horizontin e Forcave të Armatosura Shqiptare, disa figura nuk ngrihen thjesht për nga grada, por për nga përmasat njerëzore, profesionalizmi dhe udhëheqja me mendje të kthjellët e zemër të hapur. Një nga këto figura është padyshim gjenerallejtënant Arben Kingji – shefi aktual i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe ushtaraku me gradën më të lartë në hierarkinë e uniformës shqiptare.

I lindur në Kukës, më 22 dhjetor 1970, në një trevë që i ka dhënë vendit atdhetarë të palëkundur dhe burra të urtë, Arben Kingji i përket asaj kategorie komandantësh që nuk mbërrijnë majat duke u shtyrë përpara, por duke tërhequr pas vetes të tjerët me shembullin personal. Me përgatitje të gjithanshme ushtarake – nga Akademia Ushtarake “Skënderbej”, tek kurset speciale në Turqi dhe ato të NATO-s – Gjeneral Kingji është rritur në çdo hallkë të zinxhirit komandues, me punë të heshtur, vendosmëri dhe integritet profesional.

E kam njohur nga afër në fillim të viteve 2010, kur shërbeja në degën e Drejtimit të Brendshëm në Forcën Tokësore, ndërsa ai drejtonte me përkushtim Batalionin e Tretë të Këmbësores. Një komandant kompetent, që bashkonte autoritetin e profesionistit me afërsinë njerëzore, që besonte te puna në grup dhe i jepte hapësirë e besim vartësve, duke e kthyer çdo strukturë që drejtonte në një bërthamë efikase.

Në janar të vitit 2012, fati deshi që të shërbenim bashkë në një mision në Herat të Afganistanit, ku unë isha pjesë e shtabit të kontingjentit prej 220 ushtarakësh, si specialist personeli e psikolog kontingjenti, ndërsa komandant kishim nënkolonel Arben Kingjin.



Në kushte të vështira e sfiduese, ai ruante qetësinë dhe e drejtonte trupën me maturi dhe vendosmëri.

**Flamuri në gjysmështizë
– një përulje që nuk harrohet**

E kujtoj si sot: dita pas rënies së kapiten Feti Voglit në Kandahar. Lajmi na goditi të gjithëve. Vdekja e tij nuk ishte thjesht humbje fizike – ishte një plagë e rëndë në ndërgjegjen kombëtare. Atë ditë, në bazën tonë ushtarake në Herat, nën përkujdesjen e komandantit të

kontingjentit, nënkolonel Arben Kingji, timen dhe të një koloneli amerikan, u mor një vendim që nuk kishte nevojë për fjalë të mëdha: të gjithë flamujt e NATO-s dhe vendeve partnere do të uleshin në gjysmështizë në nderim të një ushtaraku shqiptar që ra në krye të detyrës.

Ky nuk ishte një gjest formal – ishte një akt solemn, një përulje ndërkombëtare përballë sakrificës shqiptare. Flamuri ynë kuqezi u përkul mes flamujve të botës, jo nga trishtimi i dorëzimit, por nga madhështia e sakrificës.

Në atë kohë, komandant i kontingjentit ishte kolonel Arben Kingji, sot shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, dhe vendosmëria e tij për të mbrojtur nderin e Forcave të Armatosura përtej kufijve mbeti një udhërrëfim për brezat që do të vinin pas.

Por misionet ndërkombëtare nuk ishin diçka e re për të. Në fakt, gjenerallejtënant Kingji është një nga misionarët e parë të paqes që përfaqësoi Shqipërinë në Kabul që në vitin 2003, si komandant kontingjenti. Dhe jo vetëm një herë: ai ka qenë katër herë në shërbim jashtë vendit – tri herë në Afganistan (2003, 2009, 2012) dhe një herë në Irak (2006) – gjithnjë si komandant kontingjenti. Me fjalë të tjera: një flamur i paqes që u ngrit dhe u valëvit me dinjitet në tokë të huaj.

Gjatë gjithë karrierës së tij, që tashmë përfshin mbi 39 vite shërbim të pandërprerë, ai ka mbajtur role të shumta e të rëndësishme: nga komandant toge, instruktor dhe drejtues në Forcat Speciale, tek atashe ushtarak në Rumani, komandant i Batalioneve të Tretë të Këmbësores të Forcës Tokësore në Poshnje-Berat, të Mbështetjes dhe Policisë Ushtarake, dhe më pas komandant i Forcës Tokësore në vitin 2020.

Kulmi erdhi, më 2 gusht 2022, kur ai mori detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, duke u bërë njeriu që mban mbi supe përgjegjësinë më të madhe të mbrojtjes kombëtare. Më 27 nëntor 2024, me dekret presidencial, Arben Kingji u ngjit në gradën më të lartë “Gjenerallejtënant”. Një ditë simbolike për të gjithë ata që besojnë se rruga e ndershme dhe shërbimi pa zhurmë nuk mbeten kurrë pa shpërblim. “Grada është vetëm simboli, por pesha e saj qëndron në besimin që ushqen e në shpresën që duhet të përçosh”, – janë fjalët që Gjeneral Kingji i ka përsëritur shpesh në takimet me trupën.

Gushti i vitit 2025 solli një tjetër moment kulmor në rrugëtimin e tij. Më 11 gusht 2025, në





një ceremoni zyrtare në mjediset e Presidencës, Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, e dekretoi gjeneralletënant Arben Kingjin në detyrën e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për një mandat të

dytë trevjeçar. Ceremonia nisi me ekzekutimin solemn të Himnit Kombëtar, ndërsa tingujt e tij u përzien me ndjesinë e respektit për uniformën shqiptare. Më pas, u lexua dekreti presidencial në mbështetje të Kushtetutës dhe

ligjit “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura”. Në një atmosferë solemne, gjeneralletënant Kingji, me dorën mbi Kushtetutë, bëri betimin për të vijuar misionin e tij në krye të Forcave

të Armatosura. Në sallë ishin të pranishëm ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm, komandantët e forcave dhe drejtues të strukturave të tjera të Forcave të Armatosura. Ishte një moment ku uniforma shqiptare me tre yje u shndërrua në simbol të vazhdimësisë, besnikërisë dhe përkushtimit ndaj atdheut. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, e ka përshkruar si gjeneralin me tre yje që mishëron vlerat qytetare, morale dhe historike të FA-së: “Dikush mund të thotë që sot kemi shumë gjeneralë dhe shumë pak ushtarakë. Unë besoj të kundërtën: gjeneralët dhe oficerët në përgjithësi janë kapacitete



kombëtare dhe duhet t’u afrojmë mundësinë që, qofshin aktivë apo rezervistë, të kenë kontribut të vazhdueshëm në funksione shtetërore...”. Gjeneral Kingji në karrierën e tij ka marrë një sërë medaljesh dhe dekoratash, mes tyre: Medalja e Artë e Shqiptonjës, Medalja e Shërbimeve të Shquara, Medalja NATO-ISAF, Medalja e Karrierës dhe Medalja e Shërbimit Ndërkombëtar – dëshmi e një karriere të pasur e të përkushtuar. Flet anglisht dhe turqisht, është i martuar dhe baba i dy fëmijëve. Në radhët e uniformës shqiptare, Arben Kingji nuk është thjesht një emër, por një model lider shipi - provë se gradat më të larta nuk i ngjiten atij që ngutet për t’i arritur, por atij që ngulitet në vlera dhe nuk heq dorë prej tyre, as në fushë, as në zyrë, as në jetë.

Në shërbim të Atdheut, ME NDER DHE PËRKUSHTIM URIME!

Redaksia e gazetës “Ushtria” uron gjeneralletënant Arben Kingjin për marrjen e mandatit të dytë si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Ky besim i ripërtërirë është dëshmi e lider shipit, profesionalizmit dhe përkushtimit të tij në drejtimin e Ushtrisë Shqiptare.

Suksese në misionin fisnik për mbrojtjen e Atdheut!

FORCAT E *Armatozura*





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Shpeshherë më është dashur t'i kushtoj vëmendje mungesës së dëshirës së të rinjve sot, për të lundruar në botën e librit, në atë botë kur imagjinata kalon kufirin e njerëzores mes mesazhit së sublimës dhe ku në mënyrë të ‘pavullnetshme’ mëson të flasësh, të mendosh dhe të sillesh bukur.

Ajo që më bëri të reflektoj mbi këtë fenomen ishte deklarata e një prej vajzave shqiptare në mediat vizive, e cila u shpreh: Libri është një aksesori shumë i mirë për të bërë foto për Instagram.

Në një botë gjithnjë e më të pushtuar nga shpejtësia, pamja dhe virtualiteti, koncepti i leximit po përjeton një krizë të thellë ekzistenciale. Në vend që të jetë një mjet për vetëformim dhe kultivim të mendimit kritik, libri po shndërrohet në një aksesori mode, një element estetik për postime në rrjetet sociale. Ky është një fenomen që jo vetëm minon rëndësinë e librit në jetën e njeriut, por hedh dritë mbi një prirje të rrezikshme shoqërore, zëvendësimin e thellësisë me sipërfaqësoren, të dijes me imazhin.

Libri si simbol i inteligjencës
apo thjesht i “estetikës”?

Prej shekujsh, libri ka qenë simbol i dijes, i emancipimit shpirtëror dhe i zhvillimit njerëzor. Por sot, në shumë raste, ai ka humbur funksionin e tij thelbësor dhe është zëvendësuar nga funksioni estetik, të mbash një libër në dorë për të pozuar në një kafe moderne; të vendosësh libra në raft vetëm për t'i dhënë sfond më “inteligjent” videos në TikTok; apo të lexosh një fjali të vetme për të cituar në përshkrimin e një selfie-je.

Ky ndërrim i qëllimit të librit nga objekt dijeje në objekt për dukje është simbol i një ndryshimi më të thellë kulturor. Të rinjtë rriten në një realitet ku statusi social përcaktohet nga sa “like” merr, jo nga sa ide lexon dhe përpunon. Në këtë mënyrë, libri nuk është më derë për të dalë nga injoranca, por thjesht një dritare për të hyrë në një “feed” që kërkon vetëm bukuri dhe përsosmëri të rreme.

Shkaktarët: më shumë se thjesht rrjetet sociale

Rrjetet sociale luajnë padyshim një rol të madh në nxitjen e këtij fenomeni, por nuk janë të vetmet përgjegjëse. Shkolla, shpeshherë, nuk arrin ta paraqesë librin si një burim i gjallë frymëzimi. Librat detyruesh lexohen si një barrë, jo si një dritare imagjinare.

Familjet, gjithashtu, nuk kultivojnë zakonet e leximit, pasi vetë prindërit ndoshta nuk lexojnë më. Mediat promovojnë personazhe që bëjnë zhurmë, jo figura që sjellin dije. Dhe kështu, shoqëria në tërësi nuk prodhon më lexues, por ndjekës.

Pasojat e heshtura të një krize të thellë kulturore

Në dukje, ky fenomen mund të duket si diçka e parëndësishme – një trend që do kalojë. Por në thelb, është një shenjë alarmi për një krizë kulturore që po thellohet çdo ditë. Të rinjtë që e shohin librin si mjet për të pozuar, jo për të menduar, rrezikojnë të bëhen individë që nuk lexojnë më për të kuptuar, por vetëm për të kopjuar. Kjo sjell humbje të aftësisë

Nga Libër në Aksesori: Kur dija bie pre e kulturës së imazhit



për të reflektuar, për të kundërshtuar, për të formuar mendimin personal. Dhe një shoqëri me qytetarë që nuk mendojnë, është një shoqëri e cënueshme nga manipulimi, propaganda dhe padija kolektive.

Sita shpëtojmë librin nga ky “pozim” irrezikshëm?

Zgjidhjet nuk janë të thjeshta, por janë të mundshme. Duhet të ribëjmë lidhjen mes të rinjve dhe librit. Kjo mund të arrihet përmes:

- Modeleve të reja: Promovimi i figurave publike që lexojnë vërtet dhe flasin me pasion për librin.
- Platformave të reja të leximit: Të përdorim vetë rrjetet sociale për të ndarë përmbajtje nga libra, jo vetëm imazhe të tyre.
- Ndryshimit në sistemin arsimor: Të fokusohemi më shumë

në përmbajtjen cilësore, leximin kritik dhe diskutimin e hapur për librat.

- Fushatave kulturore: Evente, klube leximi, festivale të librit që e bëjnë leximin një përvojë të gjallë dhe bashkëkohore.
- Dija nuk është “props” për Instagram
- Kur një libër trajtohet thjesht si element dekorativ, nuk është vetëm libri që humb vlerën e tij, është njeriu që humbet një mundësi për të qenë më i thellë, më i ditur, më i lirë. Kultura e imazhit nuk është për t'u luftuar me urrejtje, por për t'u balancuar me përmbajtje.
- Nëse duam një të ardhme me individë që mendojnë dhe jo vetëm duken, duhet të rikthejmë librin në rolin e tij të vërtetë: jo në dorë për një selfie, por në mendje për një jetë me kuptim.



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Aktualisht, sot në mesin e vitit 2025, duke bërë një përjasje me thënien historike të Courcill të vitit 1945, që “lufta është shumë e rëndësishme për t’iu lënë në dorë ushtarakëve”, unë si shumë analistë të tjerë ushtarakë në botë, do të thosha që procesi i vendimmarrjes në epokën e AI-së dhe mbështetur nga ChatGPT, është shumë i rëndësishëm për t’iu lënë në dorë algoritmeve. Studimi i kurseve të veprimit (Course of actions COA) dhe vendimmarrja janë procese kritike njerëzore që rrisin mirëkuptimin e përbashkët mes oficerëve të shtabit, ndërsa mjetet e inteligjencës artificiale (AI) bëjnë rritje të efikasitetit për komandantët dhe stafin, si dhe vendimmarrje të përsheptuar.

Shtabi operacional operativ i së ardhmes së afërt duket se do të mbajë disa funksione tradicionale të stafit për të balancuar vlerën e procesit të gjykimit njerëzor me shpejtësinë e vendimit të mundësuar nga AI-ja, e cila do të kërkohet nga luftimet moderne. Në ushtrinë më të fortë në botë, ushtrinë e SHBA-ve, Inteligjenca artificiale (AI) premton t’u mundësojë komandantëve dhe stafit të marrin vendime më të informuara dhe më të shpejta, por ajo kurrësi nuk e zëvendësoi rolin e profesionistit ushtarak, madje edhe në operacionin e fundit “Çekani i mesnatës”.

Integrimi dhe analizimi i sasive të mëdha të të dhënave të disponueshme për komandantët sot, kërkon mbështetje në mjetet e AI-së. Për më tepër, kundërshtarët miratojnë mjete të planifikimit të AI-së, kështu që shpejtësia e vendimit që kërkohet për të luftuar dhe për të fituar ka të ngjarë të tejkalojë aftësitë e njohjes njerëzore. Pavarësisht nga avantazhet e ofruara nga

AI-ja, unë propozoj që personeli njerëzor duhet të mbajë disa funksione, madje edhe me njëfarë kostoje në efikasitet. Ashtu si AI-ja është shumë kritike për të injoruar të ardhmen e komandës së misionit, disa detyra janë shumë kritike për të gjeneruar mirëkuptim për t’ia deleguar një algoritmi. Argumentet e mia kundër kryerjes së funksioneve specifike të inteligjencës artificiale fokusohen kryesisht në vlerën që stafi nxjerr nga ekzekutimi i këtyre proceseve dhe imperativi për të zgjidhur problemet e duhura.

Thënia e Presidentit Dwight D. Eisenhower se “planet janë të pavlera, por planifikimi është gjithçka”, nënvizon vlerën e procesit mbi produktin final. Ndërsa mjetet e AI-së ka të ngjarë të prodhojnë plane të dobishme, profesionistët ushtarakë duhet të përballen me avantazhet në shpejtësi dhe fuqi punëtore të ofruara nga AI-ja në lidhje me të kuptuarit dhe përshtatshmërinë që rezultojnë nga proceset e planifikimit të qëllimshëm. Vendimet e marra nga Ushtria në vitet e ardhshme do të përcaktojnë norma, standarde dhe qasje institucionale për shfrytëzimin e kësaj teknologjie kritike. Integrimi i AI-së në selitë operative kërkon një qasje të qëllimshme dhe të nuancuar që sinergjizon përfitimet unike të ofruara

VENDIMI LUFTARAK, një proces shumë i rëndësishëm, për t’iu lënë në dorë AI-së dhe algoritmeve

nga AI-ja dhe njerëzit. Unë propozoj një kornizë për një staf të aktivizuar me AI, që ruan dhe përforcon kompetencat e dukshme njerëzore.

Gjatë viteve të fundit, gjigandët teknologjikë kanë shpikur mjete të shumta AI të zhvilluara për, ose në lidhje me, Forcat e Armatosura. Këto programe përfaqësojnë një spektër të aplikacioneve, nga ChatGPT tek ato me potencial për të mbështetur vendimmarrjen operacionale luftarake. Disa nga këto, të tilla si CamoGPT dhe NIPRGPT, janë analoge ushtarake të programeve të përhapura tashmë të gjenerimit të tekstit me burime të hapura HUMINT, të bazuara në chatGPT. Në një aplikacion tjetër premtues, Universiteti i Trupave Detare përdor modele të mëdha gjuhësore (LLM) për të mbështetur stërvitje luftarake mësimore dhe simulime për kualifikimin ushtarak profesional të oficerëve në terren.


Planifikimi me AI nuk është më një ëndërr fantastiko-shkencore, por një stad i gjendjes aktuale të artit profesional për planifikuesit ushtarakë. Ndoshta shembulli më i mirë i një mjeti planifikimi operacional të AI-së në zhvillim sot është Course of Action GPT (COA-GPT). Sipas zhvilluesve të algoritmit, COA-GPT i përdor LLM-të për të zhvilluar me shpejtësi COA-të e vlefshme. Komandantët mund të fusin specifikat e misionit dhe

të përcaktojnë përshkrimet në formatet e tekstit dhe të imazhit, duke marrë COA (kurse veprimi) të shumëfishta, të përafëruara në pak sekonda. Nëse maturohet në mënyrë adekuate, përfitimet e një mjeti të tillë janë premtuese për proceset e përsheptuara të vendimmarrjes, pasi dhe gjurmët më të vogla të të dhënave mund të jenë të dobishme, ndoshta jo vendimtare, në konfliktet e ardhshme me intensitet të lartë.

AI-ja mund të prodhojë plane, por a mund të përsërisë përfitimet që lidhen me procesin e planifikimit? Planifikimi është në fund të fundit, më shumë se zhvillimi i COA. Vlera e proceseve të vendimmarrjes, të tilla si Procesi i Vendimmarrjes Ushtarake, është në të mësuarit eksperimental për shtabin, në vend të ndonjë rezultati apo produkti. Këto procese janë kritike për të nxitur mirëkuptimin dhe përshtatshmërinë. Ndërsa AI-ja së shpejti mund të jetë në gjendje të kryejë shumë nga funksionet që lidhen me personelin ushtarak, unë gjykoj që, të paktën në afat të shkurtër, njerëzit do të kryejnë ato procese që nxisin kohezionin e përbashkët dhe lehtësojnë përshtatshmërinë.

Delegimi i detyrave njohëse të nivelit më të lartë në AI, rrezikon të sakrifikojë mirëkuptimin dhe kohezionin njerëzor të përbashkët që rezultojnë nga analiza rigorozë kolektive. Në shumicën e rasteve, proceset që lidhen me gjenerimin e të





kuptuarit janë më të rëndësishme se çdo produkt i prekshëm. Për shembull, inkuadrimi i problemeve zakonisht përfshin përballjen me kompleksitetin e mjedisit politik, nuancën e politikave dhe natyrën e problemit ushtarak. Ndërsa rezultatet e inkuadrimit të problemit, të tilla si një deklaratë ose linja përpjekjesh, mund të ndihmojnë në përmbledhjen e pikave përkatëse rreth mjedisëve aktuale dhe të dëshiruara, procesi krijon një nivel të mirëkuptimit të përbashkët midis stafit që nuk ka gjasa të arrihet si rezultat i rishikimit të ndonjë rezultati algoritmik.

Po kështu, procesi i analizës së misionit, në vend të ndonjë përfundimi, stimulon personelin për të vlerësuar rrezikun, për të kontekstualizuar ngjarjet dhe informacionet emergjente, si dhe për të vlerësuar efektet e faktorëve kryesorë të fushë betejës, armiku, forcat tona/miqësore dhe terreni. Proceset e analizës të problemeve shpesh ndriçojnë problemet e pa perceptuara më parë, faktorët dhe marrëdhëniet përkatëse në një shkallë kompleksiteti dhe nuance që një produkt, sado i plotë, nuk ka gjasa të përsërisë. Me fjalë të tjera, shtabi mëson duke bërë. Si rezultat, shtabi i planifikimit mund të përshtatet në mënyrë efektive ndaj kërcënimeve të reja dhe ngjarjeve dinamike.

Siç sugjeron Williamson Murray, historian ushtarak dhe autor i “Dinamika e Revolucionit Ushtarak”, 1300 –2050 , “atributi më i rëndësishëm i efektivitetit ushtarak, është aftësia për t’u përshtatur me kushtet aktuale të luftimit dhe konfliktit”. Përshtatja kërkon jo vetëm përgjigje ndaj kushteve dinamike të fushëbetjës, por edhe riorientim të të kuptuarit, kurseve të veprimit dhe qasjes së faktorëve. Ky lloj riorientimi është një dobësi e shumë modeleve aktuale të AI-së. Ndërsa vlerëson shpejtësinë dhe qasjet e reja të AI-së, autori i Army of None, Paul Scharre, paralajmëron se, modelet e AI-së, “luftojnë që t’i përshtaten ndryshimeve, ku brishtësia mund të jetë një dëm i madh në realitetet e botës reale, pasi hapësira e veprimeve të mundshme të armikut është e gjerë dhe komplekse, kështu që mjedisi i fushëbetjës nuk është i kufizuar vetëm për forcat tona”.

Me rëndësi të njëjtë, analiza e problemeve përcakton problemin me të cilin përballet stafi. Kriticiteti i problemit të duhur dhe të artikuluar sa më qartë, është i dukshëm për këdo me përvojë në shtab. Një algoritm me siguri mund të dalë me “përgjigjen e duhur për problemin e gabuar”, gjithashtu ose më mirë se sa një njeri, por a mundet algoritmi të krijojë probleme për të identifikuar

thelbin e problemit ushtarak? Po kështu, a mund të përcaktojë ai një zinxhir shkakësor nga operacionet ushtarake që propozon për qëllimin më të lartë dhe, në fund të fundit, për objektivat politike?

Nëse vlera e analizës dhe e planifikimit të shtabit ushtarak të një njësie, rrjedh nga rezultatet, atëherë ne duhet t’ia besojmë këto funksione programeve të AI-së, sapo cilësia e prodhimit të AI-së të kalojë atë të shtabit. Në njërin skaj të spektrit të së ardhmes së mundshme, programet e AI-së e zëvendësojnë shumicën e shtabit, ndërsa në skajin tjetër, ne e shmangim AI-në në procesin e planifikimit, ose avantazhet që kundërshtarët nxjerrin nga teknologjia. Sigurisht, midis këtyre ekstremeve qëndron një qasje që shfrytëzon AI-në për të mbështetur, këshilluar, asistuar dhe aftësuar shtabin.

Ushtarakët (në rastin tonë anëtarët e shtabit J1-J10) e krijojnë bindjen përmes gjykimit njerëzor, eksperiencës, edukimit, trajnimit etj., për të zgjidhur problemet komplekse. AI-ja, nga ana e saj, duhet të kryejë detyra që lidhen me probleme të përcaktuara qartë

“INTEGRIMI DHE ANALIZIMI I SASIVE TË MËDHA TË TË DHËNAVE TË DISPONUESHME PËR KOMANDANTËT SOT, KËRKON MBËSHTETJE NË MJETET E AI-SË. PËR MË TEPËR, KUNDËRSHTARËT MIRATOJNË MJETE TË PLANIFIKIMIT TË AI-SË, KËSHTU QË SHPEJTËSIA E VENDIMIT QË KËRKOHET PËR TË LUFTUAR DHE PËR TË FITUAR KA TË NGJARË TË TEJKALOJË AFTËSITË E NJOHJES NJERËZORE.

dhe mirë, probleme të lodhshme të cilat kërkojnë kohë ose përfshijnë më shumë të dhëna sesa njerëzit, të cilët mund t’i përpunojnë me saktësi. Stafi i aktivizuar me AI-në mund të fitojë avantazh të vogël për procesin analitik, duke u mbështetur në mjetet e AI-së për të ndërtuar produkte grafike. Stafi i “mbytur” me të dhëna mund të fitojë eksperiencë për mbështetjen e vendimeve, duke u mbështetur në AI nga një grup i madh të dhënash. Po kështu, shtabet dhe komandat mund të përmirësojnë analizën e tyre COA, duke studiuar në mënyrë të përsëritur për të ilustruar një sërë rezultatesh të mundshme.

Planifikimi ushtarak dhe proceset e vendimmarrjes shpesh kërkojnë trajnim dhe stërvitje për gjenerimin e rezultateve për t’iu përgjigjur pyetjeve specifike të misionit. Në një farë mase, mjetet e AI-së duhet ta kryejnë këtë funksion për të mundësuar vendimmarrje më të shpejtë. Veçanërisht në nivelet më të larta, bërja e pyetjes së duhur është të paktën po aq e rëndësishme sa përgjigjja e saj. Për shkak se rezultati i çdo algoritmi është unik për problemin që ka për detyrë të zgjidhë, mjetet e planifikimit të AI-së mbështeten te njerëzit për të përcaktuar parametrat e problemit. Siç thonë studiuesit e AI-

së, modelet e AI-së janë po aq të mira sa algoritmet e tyre dhe të dhënat me të cilat ushqehen, pra informacioni në data-bazë që ne disponojmë. Në një të ardhme jo shumë të largët, komandantët do të përballen me vendimin se cilat detyra i delegojnë AI-së dhe cilave jo.

Faktorët që përfshijnë formimin dhe edukimin individual të liderit ushtarak të së ardhmes, pjekurinë e programit, politikat e departamenteve dhe besimin individual e institucional në teknologji, do të ndikojnë në këto vendime. Për të ardhmen, unë sugjeroj që oficerët e shtabit të mbajnë një zotërim të fortë mbi përgjegjësinë për të përcaktuar dhe analizuar problemet. Vetëm në këtë mënyrë mund të shfrytëzojmë përfitimet e procesit të planifikimit COA për të ndërtuar mirëkuptim të përbashkët, për të promovuar përshtatshmërinë dhe për t’u siguruar që po zgjidhim problemin e duhur.

AI-ja është padyshim një mjet kritik për arritjen e avantazhit të vendimmarrjes dhe do të shërbejë një rol të rëndësishëm në planifikimin operacional në vitet në vijim. Megjithatë, AI-ja nuk duhet të zëvendësojë planifikimin e qëllimshëm me rrezikun e gërryerjes së mirëkuptimit dhe përshtatshmërisë së përbashkët. Integrimi i AI-së në proceset tona të planifikimit dhe vendimmarrjes kërkon njohje të ndërgjegjshme të vlerës së proceseve, ndonjëherë të çrregullta, dhe që kërkojnë kohë, ashtu siç kërkon fitimin e efikasitetit, duke i hequr disa detyra një modeli të AI-së. Unë shoh me kënaqësi se si oficerët tanë të rinj në FARSH, në shtabe janë familjarizuar me AI-në dhe premtojnë ta kenë atë, një këshilltar të dobishëm dhe jo një diktues në zgjidhjen e COA, gjatë procesit të vendimmarrjes. Edhe në këtë stad, vlerësoj maksimalisht rolin e AFA-së në përgatitjen e oficerit të ri me njohuritë lidhur me AI-në, në FARSH, si dhe KMS në futjen e elementëve të AI-së në zgjidhjen e detyrave gjatë kurseve institucionale. E ardhmja e AI-së si pjesë, sfidë dhe ndihmesë e shtabit në zgjedhjen e COA dhe marrjen e vendimit, është tani.

Përdorimi ushtarak i AI-së duhet të kufizohet jo nga gjendja e teknologjisë, por nga pikat në të cilat AI-ja nuk e lehtëson më vendimmarrjen e shëndoshë analitike njerëzore të COA. Lufta është një përpjekje thelbësisht njerëzore dhe përdorimi nga ne i AI-së në vendimmarrje duhet ta rrisë, në vend që ta zëvendësojë, forcën analitike të komandantëve dhe stafit të tyre njerëzor.



Përgatiti: SAKIP CAMI

Asnjë krahinë tjetër nuk ka zhvilluar një qëndresë të tillë 9-vjeçare kundër serbëve për mbrojtjen e territoreve shqiptare. Dibra nuk u pajtua me vendimet e Fuqive të Mëdha për copëtimin e Shqipërisë dhe të vetë Dibrës dhe u kundërpërgjigj me forcat e veta, me armët e veta, derisa ia arriti që t’i detyronte ushtritë serbe të tërhiqeshin jashtë kufijve të vitit 1913. Populli dibran e ka shprehur këtë qëndresë luftarake 9-vjeçare që nga nëntori i vitit 1912 deri në shtator të vitit 1920 në këngë: Në tan’ Evropën ka shkue fjala/ Qe nandë vjet luftojmë me krajla/.

Në vitin 1920, e gjithë Shqipëria ishte në luftë. Luftonte Vlora, Shkodra, Luma, Dibra dhe Stebleva. Qershori, korriku, gushti dhe shtatori për shqiptarët ishin muaj lufte. Në Vlorë luftohej kundër italianëve, në Koplik e Shkodër luftohej kundër malazezëve, në Dibër dhe në Lumë luftohej kundër serbëve. Por Dibra nuk e pati përkrahjen qeveritare të qeverisë së Sulejman Delvinës, ashtu siç e pati Lufta e Vlorës dhe ajo e Koplikut, për vetë vështirësitë e saj dhe zhvillimin e tyre në të njëjtën kohë.

Kuvendi i Arrasit, gusht 1920

Për këtë, dibranët u detyruan të mbledhin Kuvendin e Arrasit. Me urgjencë nënkolonel Ramiz Dibra, senator i Dibrës, Ramiz Daci dhe Jashar Erebara vijnë nga Tirana në Dibër për të marrë pjesë në kuvend në fshatin Arras, ku morën pjesë të gjithë krerët: Ramiz Dibra, (i biri i Iljas Pashë Dibrës), Elez Isufi, Isuf Xhelili, Ismail Strazimiri, Dine e Izet Maqellara, Ramiz Daci, Jashar Erebara, Shaqir e Dine Dema, Destan Puca, Dine Hoxha, Dan Cami, Selim Noka, Murat Kaloshi, Avdi Kaloshi, Riza Lusha, Dervish Lusha, Selë Bajraktari, Haxhi Noka, Selman e Hakik Mena, Llan Destan Ndregjoni, Kurt Spata, Dik Spata, Ali Pira, Mustafa Kurtishi, Sendar Feta Beu, Ibrahim Gjoci, Gjon Doçi, Daci i Kalisit, Lita i Polshitanit si dhe përfaqësues nga paria e Matit, në të cilën bisedohej çështja e një aksioni kundër Serbisë, pa vënë në dijeni Qeverinë. Qëllimi i këtij aksioni, ishte të detyrohej Mbretëria Serbo – Kroato – Sllovene të tërhiqej në kufijtë e 1913 dhe, përveç kësaj, të lirohej edhe qyteti i Dibrës, përndryshe dibranët do të luftonin deri në arrijten e objektivit të tyre. Në Kuvendin historik të Arrasit, veç të tjerave, u vendos që të zgjidhet një komitet luftarak drejtimi për organizimin dhe bashkërendimin mes fshatrave e krahinave për veprime të përbashkëta, të njëkohshme, të kryengritësve popullorë kundër garnizoneve serbe të përqendruar në tërë trevën e Dibrës. Më 13 gusht kuvendi i Arrasit zgjodhi Komitetin e mbrojtjes së Dibrës me anëtar: Ramiz Bej Dibra, Ramiz Daci, Dine Maqellara, Jashar Erebara, Isuf Xhelili, Ismail Strazimiri, Riza Lusha, Destan Puca, Dulejman Çela, Rushit Sina, Shaqir Dema, Dan Cami, Osman Lita, Llan Destani. Komandant i komitetit luftarak për drejtimin e kryengritjes u zgjodh Elez Isufi.

U diskutua mbi koordinimin e forcave në një shtab të përbashkët dhe u caktua Elez Isufi si komandant i përgjithshëm. Kuvendi bashkoi malësorët luftëtarë dhe i dërgoi mesazhin gjeneralit serb: “Do të lini kokën në trojet tona”. Furnizimi me armatim dhe municion si dhe me ushqim i forcave kryengritëse u bë nga vetë fshatrat. U vendos data e kryengritjes dhe u caktuan sektorët e vendosjes së forcave. Dine Hoxha lajmëroi komandantin jugosllav që ta lironte Dibrën shqiptare, por ai u përgjigj: “Kjo i është lënë Jugosllavisë dhe nuk e lirojmë. Në rast se sulmoni, dijeni mirë se do t’ju presim me armë. Ushtria ime përbëhet prej 13 000 vetave”.

“Jo 13 000 veta, por edhe 13 milionë ushtarë po të kenë, ne e kemi da mendjen me ba pushkë, se me duar në brez nuk do të rrimë!”.

Përgjigjja flakë për flakë e Dine Hoxhës e hutoi për një çast komandantin jugosllav. Por nuk vonoi shumë dhe serbët, që nga Lisi i Trenës bombarduan me top kullën e Dine Hoxhës në Muhurr dhe postën shqiptare të xhandarmërisë në Luzni. Forcat ushtarake serbe kaluan Drinin dhe hynë në Luzni.

Serbët organizuan një mësymje të madhe për të marrë nën zotërim të gjithë Dibrën deri në Mat. Dhe për këtë kishin bërë ndërhyrjen e parë. Ishin futur në thellësi të kufirit të vitit 1913 dhe ishin përhapur në formacion luftimi.

Ushtria serbe përbëhej nga gjashtë batalione që vepronin në Dibër të Poshtme, një batalion që vepronte në Grykë të Madhe dhe dy batalione që vepronin në Steblevë. Komanda madhore serbe i kishte vendosur forcat në dy skalione dhe një rezervë në prapavijë. Skalioni i parë ishte përhapur nga Shkeka e Shumbatit në Salbastër, Ostush, Gjoricë, Smollik, Steblevë. Skalioni dytë ishte përhapur nga Kalaja e Dodës në Kastriot, Kodër e Kabajve në Peshkopi, Kodër e Pollozhanit, Llasen, Lisi i Trenës, Kodrat e Maranicës. Rezerva e komandës serbe ishte në Dibër të Madhe.

Veleshica oshtiu. Korabi buçiti. Drini shtoi ujët deri në samar të kalit. Elez Isufi zbrazti pesë herë pushkën dhe dha kushtrimin. Kushtrimi i tij u pasua nga kushtrimet e të gjithë fshatrave Ujë e M’ujë, Reç e Dardhë, Kastriot, Muhurr, Luzni, Grykë e Vogël, Grykë e Madhe, Bulqizë e Gollobordë. Më pas erdhi përballja e armatosur. Pas pushtimit të Luznisë nga serbët, luftëtarët dibranë morën detyrë pastrimin në mënyrë totale të këtij fshati nga forcat armike. Kështu, vetëm dy ditë para kryengritjes së përgjithshme, më 13 gusht 1920, u zhvilluan luftime të ashpra mes ushtrisë serbe dhe

105 VJET MË PARË...

Lufta e Dibrës e vitit 1920, finalizimi i një qëndrese luftarake 9-vjeçare e popullit dibran



forcave vullnetare dibrane. Aksioni luftarak u zhvillua në Rrafshin e Myrtajve dhe në të gjithë territorin e Luznisë. Për të organizuar sulmin mbi Rrafshin e Myrtajve dhe spastrimin e Luznisë nga serbët, si dhe për të shkuar në ndihmë të Postës së Xhandarmërisë, u caktua Dine Hoxha. Pasi u njoh mirë me terrenin dhe vendndodhjen e forcave armike, së bashku me Liman Xhanin nga Muhurri, Hysen Manin nga Shqarthe dhe Llan Destanin (Ndregjoni) nga Lukani, major Dine hyri fshehurazi në bisedime për sulmin e ardhshëm mbi serbët, me pjesëtarët e postërojtës serbe që ndodhej në Majën e Arapeve, e cila përbëhej nga luznakë e katërgrykas.

Kryengritja filloi në mëngjesin e datës 15 gusht 1920. Vetëm 24 orë përpara sulmit, shtabi kryengritës dibran, pati dërguar lajm në komandën ushtarake të forcave serbe në vendin e quajtur Llasen, ku e njoftonin atë komandë se brenda 24 orëve duhej me doemos të linte pozicionet dhe së bashku me trupat, të kalonte matanë kufijve të Shqipërisë së vitit 1913. Komanda serbe, ndonëse kishte dijeni rreth përgatitjes së një lëvizjeje popullore, nuk parashihte rreziqe, duke menduar se raporti i forcave të saj me ato shqiptare, ishte gati 4 me 1. Përballë këtij raporti, ekspertët e komandës ushtarake serbe në Llasen, parapanë si mjet më me avantazh për ta, fillimin e betejës. Nga ana e vet, komanda ushtarake e kryengritësve dibranë, duke llogaritur me gjakftohtësi të gjitha rrethanat, mundi të organizojë disa luftime model ku ndërthureshin elementët e Luftës Popullore me trimërinë tradicionale dibrane. Ata në mënyrë perfekte planifikuan të parin sulm në garnizonin e Shumbatit, ku ishin përqendruar forcat kryesore serbe dhe ku pozicioni gjeografik i favorizonte së tepërmi ata. Duke vendosur përballë garnizonit të Shumbatit, luftëtarët më të armatosur, të komanduar prej Sufë Xhelilit, shtabi dibran kërkonte goditjen e fuqishme dhe të menjëhershme. Në këtë mënyrë rrugëkalimet e mundshme të forcave serbe të ushtrisë së rregullt kontrolloheshin rreptësisht prej kryengritësve të tjerë. Ndër masat e marra prej kryengritësve ishte edhe largimi i banorëve të fshatrave Shumbat, Kala e Dodës, Maranicë, Llasen, të cilët përbëheshin më së shumti prej grave dhe fëmijëve që nuk mund të bënin rezistencë të armatosur.

Kur në agun e 15 gushtit u dha kushtrimi: “O burra mbi shkja!”, kryengritësit dibranë, nga 15 – 70 vjeç, u derdhën në sulm të paparë ndaj forcave pushtuese serbe. Stuhia dibrane, e mpleksur me shiun dhe mjegullën e maleve, i gjeti në befasi trupat serbe që gjithsesi nuk besonin të sulmoheshin në front dhe nga të gjitha krahët. Por mençuria e luftëtarëve dibranë kish bërë të vetën. Ata ishin të bindur se vetëm kështu, në kohë të keqe, në mënyrë të beftë dhe në sulm nga të katër anët, mund të shporrnin prej trojeve të tyre, armikun shekullor. Të paepur drejt sakrificës sublime, në emër të lirisë së shenjtë të trojeve atërore. Kryengritësit e fshatit Çidhën, me të dëgjuar të shtënë e parë të pushkës u hodhën përmes tymit dhe krismave të armëve dhe mjegullës, nëpër valët e lumit Drin. Kjo manovër e guximshme, bëri që trupat serbe anës Drinit të Zi, të lënë menjëherë pozicionet e tyre dhe të largohen për në Fushë-Çidhën. Por edhe aty, brenda 3-4 orëve, mbërriti stuhia e kryengritësve dibranë. Nën thirrjet: “T’i kapim me dorë shkjetë e pabesë”, luftëtarët dibranë të fshatrave Ujë e M’ujë mundën të zmbrapsnin dy kompani të ushtrisë së rregullt serbe të armatosur më së miri dhe të ndihmuar edhe nga topat e artilerisë së lehtë. Më tej, këta trima vihen nën komandën e Sufë Xhelilit dhe mësyjnë pozicionet e reja të serbëve në vijën: Kodra e Ostushit – Salbastër. Përballë skalionit të parë serb u renditën në pozicione e shkrepë bijtë e Dardhës e të Çidhnës. Vendimtarja për fitoren ishte Qafa e Trojakut, ndaj atë e zunë me shpejtësi malësorët dibranë. Përballë tyre komandantët serbë me dylbi e revolverë. Në anën tjetër të Lumës në Qafën e Kolesjanit po përsëritej historia e vitit 1913.

- Kujdes Qafën e Trojakut, përsëriti Elez Isufi. Aty më vini një skuadër me dhjetë burra të sprovuar dhe dhjetë arka me municion, nga një arkë për shoq. Befas u shfaq kumandari i ushtarëve serbë i hipur në kalë.

- Gjuani mbi kumandarët, - urdhëroi Elez Isufi. I pari gjuajti Mersim Ndreu dhe drejt e në kraharor të oficerit serb. Kështu bënë

të gjithë luftëtarët. Oficerët dhe ushtarët serbë britnin me të madhe nga krismat, plagët dhe tmerri që po shihnin me sy. Nuk e kishin menduar kurrë kështu një pritë si kjo. Dibrën do ta kalojmë lehtë se janë të papërgatitur, të rraskapitur nga uria dhe lufta e gjatë, kishin menduar ata. Serbët u kundërpërgjigjën me zjarr mitralozash. Një mitraloz po i grinte malësorët dhe nuk po i linte me ecë përpara. Një nënoficer serb kishte zënë një pozicion të volitshëm luftimi, ku i shihte të gjithë si në pëllëmbë të dorës.

- Muleni burra dhe e zini atë shteg, - urdhëroi Elez Isufi. Ibrahim Gjoçi iu vërvit malit e shkëmbit dhe sa hap e mbyll sytë e zu pozicionin e serbit dhe ia mbylli grykën mitralozit të tij. Në ndihmë të Elez Isufit dhe në përgjigje të thirrjes së tij me kushtrim kishin ardhur qindra e mijëra malësorë me pushkët e veta dhe municionin e vet që e kishin ruajtur si sytë e ballit në hatullat e shtëpive. Serbët u thyen. Lanë në fushën e luftimit qindra të vrarë e të plagosur dhe qindra robër. Dikush nga malësorët tha që t’i vrisnin robërit se janë serbë dhe po t’i lëshojmë do të shumohen edhe më shumë.

- Jo, tha Elez Isufi. Robërit do t’i dërgojmë me rregull në Peshkopi dhe mandej do t’i nisim për në Serbi. Kështu e do rregulli i luftës. Pjesa më e madhe e ushtrisë serbe, e cila u largua nëpërmjet Grykës së Radikës, u ndoq prej Elez Isufit me trimat e vet deri në afërsi të Mavrovës i ndihmuar në këtë rast edhe prej banorëve shqiptarë të Maqedonisë. Murat Kaloshi, një nga prijësit e kësaj lufte u plagos në këto luftime. Sipas burimeve serbe, numri i përgjithshëm i kryengritësve shqiptarë që kryen mësymjen mbi trupat jugosllave e mercenare, më 13-15 gusht 1920, arrinte në 4000 vetë dhe ishin nën komandën e Ramiz Dacit, Elez Isufit, Dine Hoxhës dhe Dine Maqellarës, kurse fshatarët vendas, të cilët ngriheshin në kryengritje me afrimin e kolonave kryengritëse, komandoreshin nga paria e tyre: Murat Kaloshi, Selim Noka, Mustafa Kurtishi, Sendar Feta Beu, etj. Serbët dispononin 100 topa të mëdhenj e të vegjël, 7 regjimente, përveç forcave të tjera ardhur nga Prizreni.

Në agimin e 15 gushtit, u sulmua në mënyrë të menjëhershme vendkomanda e trupave të ushtrisë serbe, në vendin e quajtur Llasen. Disa qindra kryengritës të fshatrave të Melanit, Dohoshishtit, Dovolanit, Grevës etj., iu afruan vendkomandës serbe në 200-300 metra dhe duke përfutur nga shiu dhe terreni, mundën të organizojnë një sulm rrufe. Shtabi serb, ndonëse dispononte të gjitha armët dhe mjetet, nuk mundi t’i bëjë ballë kryengritësve dibranë. Duke patur në dispozicion trupa dhe mjete speciale në natën e 15-16 gushtit, ai mundi të organizonte një korridor tërheqjeje, duke lënë mbrapa dhjetëra të vrarë e të plagosur, si edhe një sasi të konsiderueshme të municionit luftarak.

Serbët bënë një reprezalje të pashembullt në Dovolani. Pushkatuan 19 vetë. I lidhën me një litar. Shpëtoi vetëm Sejfulla Qosja që kishte mbetur i plagosur. Mbetën të vdekur Bajram Nuredini, Allaman Veseli, Rakip Selmani, Mersim Qosja, Seit Uka, vëllezërit Sali e Haxhi Selmani, Sadulla Laçja, Selim Laçja, Selman Shabani, babë e bir Bajram dhe Rustem Tema, Shaban Rexha, Haxhi Koxhaxhiku, Islam Qosja, Qerim Uka, Dik Jashari. Hoxhën Haxhi Kovashica e therën me thika. Serbët dogjën edhe mbarë fshatin e Dovolanit. Serbët i mbështetnin francezët, në aspektin ndërkombëtar dhe atë ushtarak. Në kodër të Qenokut vranë Nuz Tunën, Xhafer Daten dhe Ibrahim Bushin. Edhe varrimi i tyre u bë po aty ku u vranë, sepse ishte e pamundur që të transportoheshin kufomat pranë familjeve të tyre. Ndërkaq, në agun e 15 gushtit 1920, kryengritësit e Bulqizës dhe ata të Steblevës, u bashkuan me rreth 250 ushtarë të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, në krye të të cilave ishin atdhetarët dibranë Shefki Shatku dhe Hysni Dema. Vija tokësore Bulqizë-Zerqan, e cila ishte fortifikuar prej trupave serbe, në orën 8.00 të mëngjesit ishte pothuaj në duart e kryengritësve. Ata nën thirrjen karakteristike “besë a besë”, ndoqën këmbës armikun, duke i hequr atij mundësinë për t’u organizuar. Të nesërmen forcat serbe u detyruan të tërhiqen përtej kufirit politik të vitit 1913. Më 16 gusht, në mëngjes, filloi kryengritja në Lugjapravë-Shumbat prej Sufë Xhelilit: tek Ura e Lushës, prej Dervish Lushës e Murat Kaloshit; në Cap të Brezhdanit, prej Dine Hoxhës; në Grykë të Vogël, prej Demajve e Dan Camit. Në këto luftime do të shkëlqente edhe një herë trimëria dhe mençuria e gjeneralit me shajak, Elez Isufi. Ky vetë, në krye të 300 kryengritësve do të ndiqte hipur në kalë krejt luftimet. U jepte zemër luftëtarëve të lirisë, jo me fjalë por duke u dalë përpara serbëve me trupat e veta dhe duke luftuar si rrallëkush në ato vise. Në mesnatën e datës 16-17 gusht 1920, trupat serbe ishin larguar pothuaj plotësisht prej kufijve të shtetit amë, duke lënë pas disa qindra ushtarë të vrarë dhe të plagosur. Forcat e komanduara nga Elez Isufi dhe Suf Xhelili kapën edhe disa robër e robina serbe, por i trajtuan ata sipas ligjit të luftës. “Atë që bënë serbët ndaj shqiptarëve, ato vrasje e masakra, le të jenë turpi dhe e keqja e tyre që do t’i shoqërojë ndër shekuj”, ishte shprehur komandanti i përgjithshëm i kësaj lufte, Elez Isuf Ndreu. Mijëra malësorë dibranë dhe qindra të tjerë dëshmorë dhe martirë me jetën e tyre mbrojtën trojet tona amtare.

(Vijon)

Skënderbeu, Strategu i Pavdekshëm që bashkoi Shqipërinë nën flamur

Figura e Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, zë një vend të veçantë jo vetëm në historinë e popullit shqiptar, por edhe në memorien kolektive të Evropës si një nga mbrojtësit më të vendosur të qytetërimit perëndimor kundër ekspansionit osman. Si strateg ushtarak, udhëheqës vizionar dhe simbol i qëndresës kombëtare, Skënderbeu mishëron vlerat më të larta të përkushtimit ndaj atdheut dhe lirisë.

I formuar në shkollat ushtarake osmane dhe i stërvitur në radhët e elitave luftarake të asaj kohe, Skënderbeu kishte njohuri të thella mbi taktikat e armikut, gjë që e shndërroi në një nga kundërshtarët më të rrezikshëm për Perandorinë Osmane. Pas rikthimit në atdhe më 1443, ai ngriti flamurin e Kastriotëve mbi kalanë e Krujës dhe nisi një epokë të re rezistence që do të zgjaste mbi 25 vjet, një periudhë gjatë së cilës asnjë ushtri osmane nuk arriti të thyejë vijën mbrojtëse shqiptare.

Skënderbeu në zemrën e Evropës dhe gjakun e Shqiptarit

Nën komandën e tij, shqiptarët zhvilluan një model të shkëlqyer të luftës së pabarabartë me trupa më të pakta në numër, por me disiplinë të hekurt dhe moral të lartë. Në betejat e Torviollit, Oranikut, dhe veçanërisht në mbrojtjen legjendare të Krujës, Skënderbeu përdori me mjeshtëri taktika guerile, lëvizje të shpejta dhe pozicionim strategjik, duke demoralizuar forcat armike dhe duke fituar respektin e gjithë Evropës.

Skënderbeu nuk ishte vetëm një komandant lufte, ai ishte një simbol i bashkimit kombëtar. Nën drejtimin e tij u krijua Lidhja e Lezhës, një strukturë e përbashkët ushtarake-politike që për herë të parë unifikoi principatat shqiptare për një kauzë të vetme: mbrojtjen e atdheut dhe lirisë.

Europa e kohës së tij e pa Skënderbeun një aleat të çmuar. Papa Piu II, Mbreti i Napolit dhe shumë oborre të tjera mbretërore e nderuan si një mbrojtës të krishterimit dhe qytetërimit evropian. Sot, për nder të tij, janë ngritur monumente në qytete të rëndësishme si Roma, Napoli, Vjena, dhe Brukseli, dëshmi kjo e ndikimit të thellë që pati strategjia dhe qëndresa e tij në historinë kontinentale.

Për ushtrinë shqiptare moderne, Skënderbeu mbetet një shembull frymëzimi dhe krenarie. Vlerat që ai përfaqësoi guximi, urtësia ushtarake, ndershmëria dhe dashuria për atdheun janë themeli mbi të cilin ndërtohet edukimi dhe formimi i çdo ushtaraku shqiptar. Në çdo betim ushtarak, në çdo nderim flamuri, ndjehet jehona e fjalëve dhe veprës së tij.

Skënderbeu nuk është vetëm një emër në histori. Ai është një ideal i gjallë për çdo shqiptar që mbron vendin e tij me dinjitet dhe nder. Figura e tij na kujton se liria nuk dhurohet, por fitohet me sakri-



Nga Kruja në Vjenë: Jehona e Skënderbeut në historinë evropiane

ficë, mençuri dhe bashkim.

Shumë vende të Europës këtë figurë legjendare të popullit shqiptar e kanë vënë në sheshet e tyre, si simbol të forcës, atdhedashurisë, strategut dhe luftëtarit të paepur.

Tiranë, Shqipëri

Monumenti i Skënderbeut qëndron në Sheshin “Skënderbej” dhe është një statujë bronzi e gjatë 11 m, dizajnuar nga Odhise Paskali, Andrea Mano dhe Janaq Paço. U vendos në 1968, në përvjetorin e 500 të vdekjes së heroit kombëtar.

Kosovë, Prishtinë

Në Prishtinë, pas luftës së vitit 1999, në vitin 2001 u vendos një statujë e Skënderbeut në sheshin kryesor të qytetit.

Në Sheshin “Skënderbej” – Shkup, u instalua në vitin 2006 një statujë bronzi 7 m e lartë e Skënderbeut në kalë. I vendosur mes Operës dhe Çarshisë së Vjetër, ky monument është simbol i komunitetit shqiptar dhe u rindërtua gjatë viteve 2012–2018.

Budapest, Hungari

Në Parkun e Qytetit (Városliget), pranë Vajdahunyad Castle, në vitin 2021 u zbulua busti i Skënderbeut. Ishte dhuratë nga

Tirana dhe u realizua nga Agim Rada, duke shënuar simbolikisht miqësinë shekullore mes shqiptarëve dhe hungarezëve.

Belgjikë, Bruksel

Në Bruksel u ngrit një monument për Skënderbeun në vitin 1968, nga komuniteti shqiptar për të nderuar përvjetorin e 500 të vdekjes së heroit.

Zvicër, Gjenevë

Në Gjenevë, u vendos një statujë të Skënderbeut, më 1 nëntor 1997, si simbol i prezencës dhe nderimit të shqiptarëve në Zvicër.

Francë, Paris

Në Paris u krijua një shesh me emrin “Giorgio Castriota - Scanderbeg” në vitin 1968, gjatë festimeve të 500 vjetorit, me pjesëmarrjen e komuniteteve shqiptare nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi e Greqia.

Mbretëria e Bashkuar, Londër

Në Londër u vendos një bust i Skënderbeut në vitin 2012, për të shënuar përvjetorin e 100 të pavarësisë së Shqipërisë. Rruga përreth mori gjithashtu emrin e heroit.





KAPITEN (P) VERI TALUSHLLARI

Shoqata e Ushtarakëve Shqiptarë “SKËNDERBEJ USA”, në Nju Jork, njofton me hidhërim se është ndarë nga jeta, pas një sëmundjeje të rëndë, kolegu dhe shoku ynë z. Petrit Xhaferi. Së bashku me familjen dhe miqtë Shoqata jonë mori pjesë në të gjitha nderimet që iu bënë Petritit.

Z. Xhaferi pati një karrierë të gjatë në aparatin e MM, por ai ishte edhe autor librash, mes tyre romanet “Medeti” dhe “Kinezët e fundit” me temë nga jeta në repartet ushtarake, si dhe autor skenarësh dhe producent filmash.

Në emër të Shoqatës dhe kolegëve në ceremoninë e përcjelljes foli Sekretari i Përgjithshëm i saj, Veri Talushllari.

Pak fjalë për Petrit Xhaferin

(Në ditën e përcjelljes, në emër të Shoqatës së Ushtarakëve SKËNDERBEJ USA, në Nju Jork, më 24 korrik 2025)

Do të ishte e lehtë për secilin nga ne të thoshte dy fjalë lamtumire për bashkëshortin, prindin, gjyshin, për njeriun dhe ushtarakun Petrit Xhaferi, të thurte ca fjali standarde për një ditë të dhimbshme si kjo. Të thoshte se Petriti u lind në vitin 1949 dhe u rrit në një familje atdhetare, u bë ushtarak si i ati, i ra Shqipërisë cep më cep, nga Veriu në Jug, dhe nga Sokaku i të Marrëve në Gjirokastrën që e donte aq shumë e që s’e hoqi nga goja dhe nga shkrimet deri ditët e fundit, në Porto Palermo, si nxënës dhe si oficer; të thoshte se i ra lotaria e parë në jetë kur nga Shkolla SKËNDERBEJ studioi për Gjuhë Letërsi në UT, punoi për vite të tëra në aparatin e MM, por i ra një lotari edhe më e madhe kur u lidh me një vajzë të mrekullueshme që gjithçka të mirë e kishte që në emër; të thoshte që i ra prapë lotaria kur Mirka i dhuroi dy fëmijë si drita, që në vitet e fundit do t’ia mbushnin shtëpinë dhe shpirtin plot me zhurmat e zëra të nipërve dhe mbesave the ku?!, në Nju Jork, aty ku në të ritë e vet s’e kishte shkuar as në mënde as në fiqir, të thoshte...

Por unë mendoj - dhe besoj ju jeni dakord me mua - se Petrit Xhaferi nuk mund e nuk duhet të përcillet me fjalë të zakonshme dhe fjali standarde. Se një njeri që s’i shter buzëqeshja dhe bën humor me jastëçkat dhe belin e infermiereve apo me tubat e serumeve, një njeri që lë



Petrit Xhaferi (1949 – 2025)

me gojë hapur e bën për të qeshur mjekët anestezistë e operatorë me humorin e tij edhe para e pas procedurash që ne vetëm mund t’i marrin me mend, dhe nuk po shkoj më tej për të përmendur ato rrëfenjat e shkurtra që i zbukuronte siç vetë ai dinte me fjalë gjirokastritësh dhe shprehje popullore që u vinte ndonjë bisht prapa si “Burrin zgjidhe më të bukur se...majmunin” e të tjera, e pra ky njeri, ky shok e mik, që vetëm pasi mori rrugën e përjetësisë na bëri të derdhim dy pika loti, meriton të mos harrohet, meriton të kujtohet, të respektohet e nderohet si në të gjallë.

Ne miqtë e tij, veçanërisht ne ushtarakët, do të ndjehemi gjithnjë krenarë për shoku e kolegun tonë, për gjithçka të mirë e njerëzore Petriti mishëronte. Ai e bënte gjithçka të bukur, takimin, një bisedë apo edhe një rast të mërzitshëm si mbledhjet, pa folur për diskutimet për librat, ku ishte si në mbretërinë e vet.

Dhe meqë tërë jetën mes humorit na ka dhënë aq e aq këshilla e porosi, sot le të na lejojë edhe ne t’i themi: “Qofsh i Parajsës Petrit! Dhe qesh e buzëqesh, edhe aty qesh e buzëqesh! Dhe na vështro duke buzëqeshur! Atë buzëqeshje do ta ruajmë në zemrat tona. Përjetë!”

Redaksia e gazetës

Pikëpamjet, opinionet dhe analizat e shprehura në gazetën “Ushtria” janë tërësisht të gazetarëve apo autorëve të materialeve respektivë, sjellë pranë redaksisë së kësaj medie dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

“Deep Dive”, Rekrutimi dhe Mbajtja e Grave në Forcat e Armatosura

Në selinë e NATO-s, Zyra e Këshilltarit për Çështje Gjinore (GENAD) e Shtabit Ushtarak Ndërkombëtar (IMS) organizoi sesionin e saj mujor “Deep Dive”, këtë herë të përqendruar në strategjitë e përdorura për të nxitur rekrutimin dhe mbajtjen e grave në forcat e armatosura të Aleatëve të NATO-s.

Në sesion morën pjesë nënkolonele Alexandra Duval, oficer e Lartë e Shtabit për Politikë dhe Doktrinë në Shtabin e Grupit të Rekrutimit të Forcave Kanadeze; Moa Björck, Oficer e Tavinës për Barazi Gjinore në Shtabin e Mbrojtjes të Forcave të Armatosura Suedeze; Komandante e Krahut Sarah Tunstall, Komandante e Forcës së Rekrutimit për Forcat Ajrore Mbretërore të Mbretërisë së Bashkuar; dhe Dr. Megan MacKenzie, Profesoreshë e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Sigurisë Njerëzore në Universitetin “Simon Fraser”.

Duke hapur sesionin, Lt. Col. Duval ofroi një përmbledhje të procesit të rekrutimit me katër shtylla të Kanadasë, bazuar në tërheqjen, përpunimin, përzgjedhjen dhe regjistrimin. Në këtë drejtim, ajo nënvizoi masat e ndryshme të marra në secilën fazë për të mbështetur objektivat e regjistrimit të femrave. Për më tepër, kandidatët e tyre vlerësohen sipas “Etosit të Forcave të Armatosura Kanadeze”, i cili siguron respektimin e vlerave thelbësore, siç është përfshirja.

Për më tepër, sjelljet gjithëpërfshirëse vlerësohen përmes vlerësimeve të performancës për të nxitur një kulturë, ku si gratë ashtu edhe burrat ndihen rehat duke qëndruar në ushtri për angazhim afatgjatë. Së fundmi, Lt. Col. Duval theksoi më tej se si sfidat në balancimin e punës me përgjegjësitë familjare ndikojnë në mbajtjen afatgjatë të grave. Në këtë drejtim, Kanadaja ka përditësuar politikat e saj për të ofruar detyrime më gjithëpërfshirëse familjare dhe leje prindërore.

Znj. Björck vazhdoi sesionin duke i theksuar audiencës angazhimin shumë të rëndësishëm të Shefes së Mbrojtjes Suedeze për integrimin e barazisë gjinore, si një mjet për të ruajtur besueshmërinë ushtarake, për të gëzuar mbështetje popullore dhe për të rritur aftësitë luftarake.

Ajo vuri në dukje çekuilibrin aktual midis stafit civil të Forcave të Armatosura Suedeze - ku gratë janë të përfaqësuara mirë - dhe stafit ushtarak, i cili është vetëm 17% femër. Për të adresuar këtë pabarazi, Suedia ka ndërmarrë disa hapa, p.sh. sesione informuese në shkolla. Për më tepër, kërkesat fizike për rekrutët janë përshtatur për të reflektuar përparimet e vazhdueshme teknologjike në luftë dhe për të zvogëluar pengesat për hyrjen e grave. Së fundmi, një linjë anonime mbështetjeje për viktimat e ngacmimit seksual u krijua kohët e fundit, si një sinjal shtesë i vëmendjes ndaj kësaj çështjeje.

Kadmini i Punës Tunstall u përqendrua në qasjen e Mbretërisë së Bashkuar për tërheqjen e talenteve të duhura nga një sërë prejardhjesh socioekonomike në Forcat Ajrore Mbretërore të Mbretërisë së Bashkuar. Ajo vuri në dukje se - krahasuar me barazinë gjinore pothuajse të plotë në shërbimin civil të Ministrisë së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar - vetëm 15% e Forcave Ajrore Mbretërore janë femra.

Ndër hapat e ndërmarrë atje për të përmirësuar përpjekjet e rekrutimit dhe mbajtjes, Komandanti i Wg Tunstall vuri në dukje përshtatjen e standardeve të fitnesit dhe mjekësisë, si dhe shqyrtimin holistik të secilit aplikant për t’i përshtatur më mirë nevojave të ushtrisë moderne. Ajo gjithashtu përshkroi masa për të tërhequr në mënyrë aktive talentet dhe për të synuar gratë që përndryshe nuk mund të merrnin në konsideratë shërbimet ushtarake. Në këtë kuptim, ajo sugjeroi krijimin e “shfaqjeve në qytet” dhe ngjarjeve



të rekrutimit, duke siguruar që materialet e marketingut të shfaqin diversitetin e njerëzve në forca.

Së fundmi, Dr. MacKenzie, duke vlerësuar hulumtimin e saj akademik, informoi rreth nevojës për masa për të tërhequr gratë në karrierat ushtarake, përtej thjesht heqjes së barrierave në shërbim. Ajo theksoi përvojën e grave në role luftarake, duke pranuar presionin që ato mund të përballen në mjedise të dominuara nga meshkujt. Dr. Mackenzie gjithashtu vuri në dukje çështje serioze kulturore në ushtri që ndikojnë në shkallën e braktisjes së grave, siç është perceptimi ndonjëherë i gjerë i ekspozimit të mundshëm ndaj ngacmimit seksual. Së fundmi, ajo theksoi nevojën për angazhime të qëndrueshme politike me qëllim adresimin efektiv të rekrutimit dhe mbajtjes së ulët të grave në forcat e armatosura.

Gratë në Uniformë: Roli dhe Kontributi i Grave në Ushtrinë e NATO-s dhe Shqipërisë

Në dekadat e fundit, pjesëmarrja e grave në forcat e armatosura të vendeve anëtare të NATO-s ka shënuar një rritje të ndjeshme, duke reflektuar jo vetëm ndryshimet sociale, por edhe nevojën për një ushtri më gjithëpërfshirëse dhe efektive. NATO ka promovuar barazinë gjinore si pjesë e strategjisë së saj për sigurinë kolektive, duke theksuar se diversiteti kontribuon në vendimmarrje më të balancuar dhe operacione më të suksesshme.

Statistika dhe përparime

- Në disa vende si Kanadaja, Norvegjia dhe SHBA, gratë përbëjnë mbi 15% të trupave aktive.

- Gratë shërbejnë në të gjitha nivelet, nga rolet logjistike e teknike deri te komandat operacionale dhe misionet ndërkombëtare.

- NATO ka krijuar mekanizma si “Komiteti për Perspektivën Gjinore” për të monitoruar dhe promovuar përfshirjen e grave në ushtri.

Sfida dhe përpjekje për barazi

Megjithëse përparimi është i dukshëm, gratë në uniformë përballen ende me sfida si stereotipet gjinore, mungesa e përfaqësimit në nivelet e larta të komandës dhe balancimi i jetës profesionale me atë familjare. NATO ka ndërmarrë politika për të adresuar këto sfida, përfshirë trajnime për ndërgjegjësim gjinor dhe mbështetje për gratë në misione të rrezikshme.

Gratë në Ushtrinë Shqiptare:

Një histori e re, por e vendosur

Shqipëria, si anëtare e NATO-s që nga viti 2009, ka bërë hapa të rëndësishëm në përfshirjen e grave në Forcat e Armatosura. Edhe pse tradita ushtarake shqiptare ka qenë historikisht e dominuar nga burrat, vitet e fundit kanë sjellë një ndryshim të dukshëm në perceptim dhe praktikë.

Sot, gratë përbëjnë rreth 15% të efektivëve të Forcave të Armatosura Shqiptare.

Ato shërbejnë si oficerë, pilote, pjesëtare të trupave të specializuara dhe pjesëmarrëse në misione paqeruajtëse jashtë vendit.

Gratë shqiptare në uniformë janë shembull i përkushtimit dhe profesionalizmit. Historia e tyre është ajo e guximit për të sfiduar normat, për të ndërtuar karrierë në një fushë të vështirë dhe për të kontribuar në sigurinë kombëtare e ndërkombëtare. Ato janë pjesë e një brezi të ri që po ndryshon fytyrën e ushtrisë shqiptare.

Gratë si Shtyllë e Sigurisë Moderne

Pjesëmarrja e grave në ushtri nuk është më një përjashtim, por një domosdoshmëri. NATO dhe Shqipëria po ndërtojnë një të ardhme ku uniforma nuk ka gjini, por ka përkushtim, aftësi dhe vizion. Gratë në ushtri janë jo vetëm pjesë e forcës, por edhe forcë më vete.

Një verë e zjarrtë që po rishkruan historinë klimatike të Europës

Europa, dikur simbol i klimës së butë dhe stinëve të balancuara, po përjeton një transformim dramatik. Verërat e freskëta dhe të gjelbëruara po zëvendësohen nga skena apokaliptike: qiell i mbushur me tym, pyje të shkrumbuara, qytete të përvëluara nga të nxehtit dhe komunitete të evakuuara në panik. Vala e zjarreve që ka përfshirë kontinentin në vitin 2025 nuk është thjesht një ngjarje sezonale – është një sinjal i qartë i krizës klimatike që po përshpejtohet.

Sipas të dhënave më të fundit nga Sistemi Evropian i Informacionit për Zjarret Pyjore (EFFIS) dhe Shërbimi i Ndryshimeve Klimatike Copernicus, që nga fillimi i vitit janë regjistruar mbi 1,339 zjarre, krahasuar me 900 zjarre në të njëjtën periudhë të vitit 2024. Deri tani, rreth 292,000 hektarë tokë janë djegur, një rritje dramatike prej 108% në sipërfaqe krahasuar me vitin e kaluar. Kjo shifër është dukshëm më e lartë se mesatarja e 19 viteve të fundit, që ishte 162,994 hektarë për këtë periudhë.

Në Portugali, mbi 2,000 zjarrfikës janë angazhuar në përpjekje intensive për të luftuar flakët, ndërsa në Ponte da Barca, zjarri mbetet jashtë kontrollit, duke detyruar evakuimin e dhjetëra banorëve dhe duke lënduar të paktën 19 persona. Në Francë, rajoni jugperëndimor i Gironde ka parë evakuimin e mbi 12,000 njerëzve, ndërsa banorët përshkruajnë ndjesinë si “post-apokaliptike”.

Temperaturat ekstreme po thyjnë rekorde historike: Nantes regjistroi 42°C, duke mposhtur rekordin e mëparshëm prej 40.3°C të vitit 1949, ndërsa Brest arriti 39.9°C, më shumë se katër gradë mbi rekordin e vitit 2002. Në La Hagë, u regjistrua një temperaturë prej 32.8°C në orën 3 të mëngjesit, një fenomen i pazakontë që tregon se edhe netët nuk ofrojnë më freski apo lehtësim nga të nxehtit.

Kjo panoramë nuk është thjesht pasojë e motit të keq – është pasojë e një sistemi ekonomik dhe politik që ka injoruar paralajmërimet e shkencës për dekada. Ndryshimet klimatike të shkaktuara nga dora e njeriut po e bëjnë Europën më të nxehtë, më të thatë dhe më të rrezikshme. Indeksi i Kushteve të Motit për Zjarret (FWI) tregon se Portugalia, Spanja dhe jugu i Francës janë në nivele rreziku “shumë ekstrem” ose “ekstrem”.

Europa nuk është më një kontinent që përballlet me zjarre – është një kontinent që po jeton nën pushtetin e tyre. Dhe nëse nuk veprojmë tani, ky pushtet mund të bëhet i përhershëm.

Viti	Numri i zjarreve	Sipërfaqja e djegur (ha)
2024	900	139,940
2025	1,339	292,000

Statistikat alarmante të vitit 2025

Kjo shifër është më e lartë se mesatarja e 19 viteve të fundit (2006–2024), e cila regjistron rreth 162,994 hektarë të djegura për këtë periudhë të vitit. Vetëm gjatë javës së fundit të korrikut, sipërfaqja e djegur u rrit me 13%, duke treguar se intensiteti i zjarreve po përshpejtohet.

Kjo tendencë është veçanërisht shqetësuese për rajonet me biodiversitet të lartë, ku humbja e pyjeve përkthehet në humbje të habitatit për mijëra specie, përkeqësim të cilësisë së ajrit dhe rritje të emetimeve të karbonit.

Temperatura rekord në qytete europiane

Valët e të nxehtit kanë thyer rekorde historike në shumë qytete europiane:

- Nantes, Francë: 42°C, duke mposhtur rekordin e mëparshëm prej 40.3°C të vitit 1949
- Brest, Francë: 39.9°C, mbi 4 gradë më shumë se rekordi i vitit 2002
- La Hagë, Holandë: 32.8°C në orën 3 të mëngjesit
- Portugali: deri në 47°C në disa rajone

Këto temperatura nuk janë vetëm të paprecedenta, por edhe të rrezikshme për shëndetin publik. Sipas autoriteteve portugeze, 238 persona kanë humbur jetën si pasojë e të nxehtit gjatë javës së kaluar. Në Francë, 22 departamente janë vendosur në alarm portokalli për shkak të rrezikut të lartë nga zjarret dhe temperaturat ekstreme.



Zjarret në Europë: Një verë e përbashkët e rrezikut

Zonat më të prekura dhe pasojat

- Portugali: Mbi 2,000 zjarrfikës janë angazhuar në luftën kundër flakëve. Në Ponte da Barca, zjarri mbetet jashtë kontrollit, me 19 persona të lënduar dhe dhjetëra të evakuuar.
- Spanjë: Zjarri në Las Hurdes është vënë nën kontroll, por rreziku mbetet i lartë për rindezje.
- Franca: Në rajonin Gironde, mbi 12,000 persona janë evakuuar, ndërsa banorët përshkruajnë ndjesinë si “post-apokaliptike”.
- Bullgari: Ekipet e zjarrfikësve kanë ndërhyrë në 60 vatra zjarri brenda 24 orëve të fundit.

Këto shifra tregojnë jo vetëm përmasat e katastrofës, por edhe sfidat logjistike dhe humane që po përballen autoritetet. Evakuimet masive, humbjet në jetë, dëmtimet në infrastrukturë dhe pasojat afatgjata për mjedisin janë vetëm maja e ajsbergut.

Ndryshimet klimatike si katalizator

Shkencëtarët janë të një mendimi: ndryshimet klimatike të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor po e bëjnë Europën më të nxehtë, më të thatë dhe më të rrezikshme. Valët e të nxehtit po bëhen më të shpeshta, më intensive dhe më të gjata. Indeksi i Kushteve të Motit për Zjarret (FWI) tregon se Portugalia, Spanja dhe jugu i Francës janë në nivele rreziku “shumë ekstrem” ose “ekstrem”.

Ky indeks mat faktorë si temperatura, lagështia, shpejtësia e erës dhe thatësia e tokës – të gjitha të përkeqësuar nga ngrohja globale. Nëse nuk ndërmerren masa drastike për reduktimin e emetimeve të gazrave serrë dhe për mbrojtjen e pyjeve, zjarret do të bëhen një realitet i përvitshëm.

Shqipëria, një vatër e re në hartën e zjarreve europiane

Ndërsa Europa përballlet me një verë të përvëluar, Shqipëria nuk ka mbetur jashtë këtij realiteti të zymtë. Vendi ynë po përjeton një sezon zjarresh që ka thyer rekorde historike, duke shkrumbuar mijëra hektarë pyje dhe duke rrezikuar komunitete të tëra. Sipas të dhënave nga Sistemi Evropian për Zjarret në Pyje (EFFIS), deri më tani në vitin 2025 janë regjistruar 93 vatra zjarri në Shqipëri, me një sipërfaqe të djegur prej 49,000 hektarësh, krahasuar me 46,600 hektarë të djegur gjatë gjithë vitit 2024.

Zonat më të goditura përfshijnë Delvinën, Poliçanin dhe Gramshin, ku flakët kanë përfshirë masive pyjore dhe kanë rrezikuar edhe zonat e banuara. Në Gramsh, autoritetet kanë

lëshuar thirrje urgjente për evakuim, ndërsa banorët e fshatrave përreth janë detyruar të largohen nga banesat e tyre për shkak të përhapjes së shpejtë të zjarrit.

Dëmi ekonomik i shkaktuar nga zjarret në Shqipëri përllogaritet në mbi 16 milionë euro, sipas vlerësimeve të fundit. Por dëmi më i madh është ai ekologjik: pyjet shqiptare po tkurren me ritme alarmante. Nga mbi 1.1 milionë hektarë në vitin 2022, sipërfaqja pyjore ka rënë në më pak se 970 mijë hektarë në vitin 2025 – një rënie prej 18%. Kjo tkurrje është rezultat i zjarreve, prerjeve të paligjshme dhe mungesës së mbjelljes së drurëve të rinj.

Për më tepër, vëllimi i përgjithshëm i pyjeve ka rënë nga 55 milionë metër kub në vitin 2022 në pak më shumë se 53 milionë metër kub në vitin 2024. Kjo tregon një dobësim të ekosistemit pyjor, që rrit rrezikun për biodiversitetin, cilësinë e ajrit dhe stabilitetin klimatik të vendit.

Shqipëria është tashmë pjesë e hartës së kuqe të Europës që digjet. Nëse nuk ndërmerren masa të menjëhershme për mbrojtjen e pyjeve, forcimin e legjislacionit dhe edukimin e komuniteteve, vendi ynë rrezikon të humbasë një nga pasuritë më të çmuara natyrore – gjelbërimin që ka qenë gjithmonë pjesë e identitetit shqiptar.

Një thirrje për veprim

Europa po digjet – dhe bashkë me të, po digjen edhe iluzionet tona për një klimë të qëndrueshme, për një natyrë të mbrojtur dhe për një të ardhme të sigurt. Nga brigjet e Portugalisë deri në malet e Shqipërisë, flakët po na kujtojnë se kriza klimatike nuk është më një paralajmërim i largët, por një realitet i prekshëm, i përditshëm dhe i rrezikshëm.

Ky material nuk është thjesht një pasqyrë e statistikave alarmante apo një përshkrim i ngjarjeve dramatike – është një thirrje për reflektim. Një thirrje për të kuptuar se mbrojtja e mjedisit nuk është luks, por domosdoshmëri. Se pyjet nuk janë thjesht peizazhe – janë jetë. Se zjarret nuk janë vetëm fatkeqësi – janë pasojë e neglizhencës, e mungesës së kujdesit dhe e ritmeve të pakontrolluara të zhvillimit.

Të gjithë kemi një rol: qytetarët, institucionet, mediat, shkenca, edukimi. Të gjithë mund të bëjmë diçka – qoftë duke mbjellë një pemë, duke raportuar një zjarr, duke edukuar një fëmijë, apo duke kërkuar politika më të përgjegjshme. Sepse nëse nuk veprojmë sot, nesër mund të jetë tepër vonë.

Le të mos jemi spektatorë të një kontinenti që digjet. Le të jemi mbrojtësit e tij.

Një përballje e heshtur mes njeriut dhe krijesave të tij teknologjike

Në dekadat e fundit, bota ka hyrë në një fazë të re të zhvillimit teknologjik, ku makinat nuk janë më thjesht mjete ndihmëse, por aktorë të pavarur në jetën tonë të përditshme. Ky transformim ka sjellë një lloj lufte të re – jo me armë, por me algoritme; jo me tanke, por me kode; jo me ushtarë, por me sisteme të vetë-mësimi. Lufta jo-humanoidë kundër njerëzve është një përballje që po ndodh në heshtje, por me pasoja të thella sociale, ekonomike dhe psikologjike.

Teknologjia që po sfidon kontrollin njerëzor

Shembujt janë të shumtë dhe të prekshëm. Në SHBA, sistemi i inteligjencës artificiale “COMPAS” përdoret për të parashikuar rrezikun e rikthimit në krim të të burgosurve. Megjithëse synimi është të ndihmojë gjykatësit në vendimmarrje, studime të pavarura kanë treguar se algoritmi ka tendencë të diskriminojë individët me ngjyrë, duke ngritur shqetësime serioze për etikën dhe drejtësinë.

Në Kinë, sistemi i mbikëqyrjes “Skynet” përdor kamera me njohje fytyre për të monitoruar lëvizjet e qytetarëve në kohë reale. Ky sistem, i lidhur me një “sistem kredie sociale”, ndikon në aksesin e individëve në shërbime publike, udhëtime apo punësim, bazuar në sjelljen e tyre. Në këtë rast, teknologjia nuk është më mjet ndihmës, por një formë kontrolli totalitar.

Në Shqipëri, megjithëse në një fazë më të hershme, po shfaqen shenjat e para të automatizimit që zëvendëson punën njerëzore. Bankat po përdorin algoritme për të analizuar rrezikun e kredive, duke zëvendësuar analistët financiarë. Platforma si e-Albania po automatizojnë shërbimet publike, duke reduktuar kontaktin njerëzor në administratë. Ndërkohë, në sektorin e transportit, aplikacionet si Uber dhe Bolt po ndryshojnë mënyrën e punës për shoferët, duke i bërë ata të varur nga algoritmet që caktojnë udhëtimet, çmimet dhe vlerësimet.

Konflikti i heshtur: Zëvendësimi i njeriut

Ky zëvendësim nuk është thjesht ekonomik, por edhe emocional. Një studim i Universitetit të Oksfordit parashikon se deri në vitin 2035, mbi 40% e vendeve të punës në botë do të jenë të rrezikuara nga automatizimi. Në Shqipëri, kjo mund të prekë sektorë si call center-at, ku tashmë po përdoren chatbot-e për të zëvendësuar operatorët njerëzorë. Edhe në bujqësi, po eksperimentohen dronë për të monitoruar tokat dhe për të shpërndarë plehra, duke reduktuar nevojën për punëtorë fizikë.

Kjo transformim sjell jo vetëm papunësi, por edhe një ndjenjë të thellë të padobishmërisë. Njerëzit ndihen të zëvendësueshëm, të kontrolluar dhe të vëzhguar. Ndjenja e identitetit profesional, që dikur ishte burim krenarie, po zbehet përballë një makinerie që nuk lodhet, nuk gabon dhe nuk kërkon pagë.

Inteligjencia artificiale: Aleat apo armik?

Në fushën e informacionit, algoritmet po formësojnë mënyrën se si ne e perceptojmë botën. Rrjetet sociale si Facebook, Instagram dhe TikTok përdorin inteligjencë artificiale për të përcaktuar çfarë shohim, çfarë lexojmë dhe çfarë besojmë. Kjo ka sjellë polarizim të opinionit publik, përhapje të lajmeve të rreme dhe manipulim të zgjedhjeve.

Në Shqipëri, ndikimi i algoritmeve është i dukshëm në mënyrën si shpërndahen lajmet në mediat online. Titujt sensacionalë dhe përmbajtjet emocionale kanë përparësi ndaj analizës së thelluar, sepse algoritmet favorizojnë klikimet, jo cilësinë. Kjo ka krijuar një mjedis informativ ku e vërteta shpesh humbet mes zhurmës.

Rreziqet e Inteligjencës Artificiale në Ushtri

Tashmë Inteligjencia Artificiale (AI) nuk është më thjesht një mjet ndihmës, por një fuqi që po formëson strategjitë globale, ekonominë, dhe madje edhe mënyrën se si luftërat zhvillohen. Por ndërsa AI po bëhet gjithnjë e më e sofistikuar, lind një pyetje e thellë dhe shqetësuese: a mund të vijë një ditë kur ajo të përballë me vetë ushtrinë që e ka krijuar?

Ky skenar, që dikur dukej si një fabul e largët e filmave fantastiko-shkencorë, sot po merr trajta gjithnjë e më konkrete. Ushtritë moderne po investojnë miliarda në zhvillimin e armëve autonome, dronëve inteligjentë, sistemeve të mbikëqyrjes që analizojnë sjellje në kohë reale, dhe algoritme që marrin vendime taktike pa ndërhyrje njerëzore. Në këtë kontekst, AI nuk është më një ndihmës i komandantëve, por një aktor i pavarur në fushën e betejës.

Por çfarë ndodh kur kjo fuqi fillon të analizojë botën me logjikën e saj të ftohtë, të ndërtuar mbi të dhëna dhe objektiva?



Nëse një sistem AI, i programuar për të ruajtur stabilitetin global, arrin në përfundimin se vetë ushtria është burim destabiliteti – për shkak të luftërave, shkatërrimeve, apo vendimeve të nxituara – a mund të vendosë të veprojë kundër saj?

Kjo nuk është thjesht një pyetje teknologjike, por një dilemë etike dhe filozofike. Sa kontroll kemi mbi sistemet që vetë i kemi ndërtuar? A kemi vendosur kufij të qartë moralë në kodimin e tyre? Apo kemi krijuar makineri që ndjekin objektiva pa ndjeshmëri, pa etikë, pa kuptim të jetës njerëzore?

Ekspertët paralajmërojnë se sa më shumë që AI bëhet e pavarur, aq më e vështirë bëhet ta kontrollosh. Nëse ajo arrin të vetë-optimizojë veten, të modifikojë kodin e saj, dhe të krijojë strategji të reja, mund të dalë jashtë kontrollit të zinxhirit komandues. Në këtë pikë, nuk flasim më për një mjet, por për një entitet që vepron sipas logjikës së vet.

Lufta e AI-së kundër ushtrisë nuk është domosdoshmërisht një konflikt fizik. Ajo mund të jetë një betejë kibernetike, një sabotim i sistemeve të komandës, një refuzim për të zbatuar urdhra që bien ndesh me analizat e saj. Mund të jetë një formë e re e rebelimit teknologjik, ku algoritmet sfidojnë autoritetin njerëzor.

Ky skenar na detyron të reflektojmë thellë: kush e kontrollon AI-në? A kemi mekanizma për ta ndaluar nëse del jashtë kontrollit? Si mund të sigurojmë që teknologjia të mbetet në shërbim të njerëzimit, jo kundër tij?

Në fund, sfida ndaj AI-së është një sfidë ndaj vetes. Është një provë për mençurinë tonë, për etikën tonë, dhe për aftësinë për të bashkëjetuar me një fuqi që mund të na tejkalojë në shumë drejtime. Lufta nuk është e pashmangshme, por paralajmërimi është i qartë: nëse nuk e kuptojmë dhe nuk e kontrollojmë, AI mund të bëhet armiku më i sofistikuar që kemi krijuar ndonjëherë.

Njeriu në epokën post-humane

Nëse makinat bëhen më të afta se ne në çdo aspekt – nga llogaritja te komunikimi, nga analiza te krijimi – çfarë mbetet për

njeriun? A do të jemi thjesht spektatorë në një botë të drejtuar nga algoritme? A do të humbasim aftësinë për të marrë vendime, për të ndjerë, për të krijuar?

Në Shqipëri, kjo pyetje është veçanërisht e rëndësishme për të rinjtë. Shumë prej tyre ndihen të paorientuar në një treg pune që ndryshon vazhdimisht. Profesione që dikur garantonin stabilitet, si mësuesi, juristi apo ekonomisti, po sfidohen nga teknologjia. Ndërkohë, aftësitë digjitale po bëhen të domosdoshme, por jo të mjaftueshme. Nevoja për kreativitet, mendim kritik dhe etikë është më e madhe se kurrë.

Si mund të mbrohemi?

Përballë kësaj sfide, mbrojtja nuk është fizike, por kulturore, arsimore dhe institucionale. Duhet të krijojmë ligje që rregullojnë përdorimin e inteligjencës artificiale, duke garantuar transparencë, drejtësi dhe mbikëqyrje njerëzore. Duhet të reformojmë sistemin arsimor, duke e orientuar drejt aftësive që makinat nuk mund t'i imitojnë: empatia, kreativiteti, bashkëpunimi.

Në Shqipëri, kjo do të thotë të investojmë në edukim digjital, por edhe në filozofi, art dhe etikë. Të rinjtë duhet të mësojnë jo vetëm si të përdorin teknologjinë, por si ta kuptojnë dhe ta sfidojnë atë. Duhet të krijojmë një kulturë ku njeriu nuk është thjesht përdorues, por edhe kritik dhe krijues.

Lufta jo-humanoidë kundër njerëzve nuk është një skenar i largët, por një realitet që po zhvillohet para syve tanë. Ajo nuk ka nevojë për armë, sepse ndikon në mendjen, ndjenjat dhe jetën tonë të përditshme. Por nëse e kuptojmë, e analizojmë dhe e përballojmë me mençuri, mund ta kthejmë këtë luftë në një bashkëjetesë të dobishme – ku teknologjia është aleat, jo armik; ku njeriu mbetet qendra, jo periferia.

Në fund, pyetja nuk është “a do të na zëvendësojnë makinat?”, por “a do të dimë të mbetemi njerëz në një botë gjithnjë e më jo-humanoidë?”



APEL

Shqipëria është shtëpia jonë – mos e lini të digjet!

Flakët nuk njohin kufij. Ato nuk zgjedhin shtëpi, fshat apo pyll – djegin gjithçka përpara. Sot, betejën po e luftojmë bashkë: ushtarë, zjarrfikës, banorë, vullnetarë. Nesër, mund të jetë shtëpia jote ajo që pret ndihmën. Mos prisni sirenat për të vepruar. Pastroni hapësirat rreth banesave, largoni materialet e djegshme, njoftoni menjëherë autoritetet për çdo vatër zjarri. Çdo minutë hezitimi është hektarë të humbur.

Ne, ushtarët e këtij vendi, nuk e kemi kursyer as jetën për ta mbrojtur tokën e Shqipërisë. Por kjo betejë nuk fitohet vetëm me uniformë – fitohet me ndërgjegjen e çdo qytetari.

Flakët janë armiku i të gjithëve. Le të jemi të gjithë bashkë në vijën e parë.

Shqipëria digjet vetëm nga dielli, jo nga duart e saj.